

# ZBULUESIT

**Viti 1 - Tremujori 2**

**Programi Bazë**



# NJË MESAZH NGA KRIS SMOLL

Të dashur drejtues,

Ju jeni pjesë e një grupi shumë të rëndësishëm të njerëzve që janë thirrur për të ndërtuar brezin e ardhshëm të dishepujve të qëndrueshëm. Lutem që do të përjetoni gëzim të madh çdo javë ndërsa studioni Fjalën e Perëndisë dhe pastaj diskutoni rreth saj me nxënësit tuaj. Pavarësisht rolit tuaj apo moshës me të cilën punoni, ju jeni me vlerë! Efesianëve 2:10 thotë: “Sepse jemi vepra e tij, e krijuar në Krishtin Jezus për vepra të mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to.” Ky varg na kujton se të shërbyerit nuk ka të bëjë me ne, por me punën e mbretërisë që Perëndia po bën përmes nesh.

Këtë tremujor do të kuptojmë më mirë zemrën e Jezusit, ndërsa ecim përkrah Tij dhe studiojmë shërbesën e Tij në Dhiatën e Re. Shijojini pasazhet e Shkrimit dhe thellohuni personalisht në marrëdhënien tuaj me Të ndërsa përgatiteni çdo javë. Gjithashtu, kaloni kohë duke u lutur dhe duke i kërkuar Perëndisë të punojë në jetën tuaj dhe në jetën e nxënësve tuaj gjatë këtij tremujori. Për disa nga ata nxënës, ti mund të jesh personi i vetëm që lutet dhe i udhëheq frymërisht. Përgjatë tremujorit do t'i sfidojmë nxënësit të besojnë në Jezusin si Shpëtimtari i tyre, të dinë se çfarë besojnë dhe, si rezultat i njohjes së Fjalës së Perëndisë, të bëhen të guximshëm e të kenë kurajë ndërsa qëndrojnë në Jezusin në jetën e përditshme.

E bekuar që shërbej me ju!

Kris Smoll  
Drejtoreshë ekzekutive e *Discovery Land Global*

# TABELA E PËRMBAJTJES

## Viti 1 – Tremujori 2

Të kuptojmë kurikulën.....	4
Përmbledhja e tremujorit.....	9
Mësimi 1: Engjëlli lajmëron ardhjen e Jezusit dhe të Gjon Pagëzorit.....	12
Mësimi 2: Jezusi lind.....	20
Mësimi 3: Festojmë për Jezusin! .....	28
Mësimi 4: Maria dhe Jozefi prezantojnë Jezusin në tempull. ....	32
Mësimi 5: Jezusi mëson në tempull.....	38
Mësimi 6: Jezusi pagëzohet dhe refuzohet.. ....	45
Mësimi 7: Jezusi shëron vjehrrën e Pjetrit.....	53
Mësimi 8: Një grua mëkatare vajos Jezusin. ....	59
Mësimi 9: Jezusi u mëson dishepujve të mos kenë turp. ....	65
Mësimi 10: Jezusi mëson për samaritanin e mirë.....	72
Mësimi 11: Dita e përsëritjes. ....	78
Mësimi 12: Dita e testit .....	81
<b>Shtojca</b>	
Mësim tematik: Njëri-tjetrin .....	84
Lojërat e fundit të përsëritjes .....	92
Libri pa fjalë – T'u prezantojmë fëmijëve ungjillin .....	97
Falënderimet dhe lejet .....	99

# TË KUPTOJMË KURIKULËN

## Pasqyrë e përgjithshme

Kurikula është hartuar për të qenë ARGËTUESE, PËRFSHIRËSE dhe EFEKTIVE, në mënyrë që t'i motivojë fëmijët ta njohin dhe ta duan Perëndinë. Ajo është strategjike dhe e qëllimshme, dhe merr parasysh zhvillimin frymëror të fëmijëve të moshës nga gjashtëmuajsh deri në 9 vjeç.

Kurikula u hartua për t'i mësuar nxënësit në lidhje me:

1. **Biblën:** pamjen e përgjithshme të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re si një të vetme, zbuluesen e unifikuar të së vërtetës së Perëndisë për ne.
2. **Ungjillin e Jezusit:** shpëtimin me anë të hirit përmes besimit siç paraqitet në të gjithë Biblën.
3. **Bazat e krishterimit:** transformimin e jetës përmes lutjes, adhurimit, ungjillëzimit, mësimit përmendsh të Shkrimit, pagëzimit, Darkës së Zotit, të dhjetës, bashkësisë, shërbesës, misionit etj. (Listën e plotë sipas grup-moshave, mund ta gjeni në Hartën e gjurmuesit).

## Mësimet bazë mbështeten në strukturën:

KUPTO SI DUHET → MENDO SI DUHET → VEPRO SI DUHET → NDIHU SI DUHET

<b>Kupto si duhet:</b>	Një pasazh kyç nga Shkrimi – 2 e Timoteut 2:15
<b>Mendo si duhet:</b>	Një varg kyç nga Shkrimi për të medituar gjatë javës – Psalmi 1:2
<b>Vepra si duhet:</b>	Sfida për të vënë në praktikë Fjalën e Perëndisë – Jakobi 1:22
<b>Ndihu si duhet:</b>	Rezultati i zbatimit të mësimit dhe të të pasurit e një botëkuptimi biblik në vend të një pikëpamjeje laike – Psalmi 23

## Drejtuesit

Çdo klasë ka zakonisht tre drejtues: Mësuesin kryesor, Drejtuesin e kohës së zbulimit dhe Bariun.

**Mësuesi kryesor:** Është përgjegjës për mësim të qëndrueshëm biblik, që tërheq vëmendjen e nxënësve dhe krijon një rritje frymërore për ta duke ndjekur kurikulën, si dhe siguron udhëheqje për nxënësit dhe vullnetarët gjatë takimit.

**Drejtuesi i kohës së zbulimit:** Është përgjegjës për udhëheqjen e Kohës së zbulimit, një aktivitet prej 15 minutash, i cili është edukativ, energjik, ndërveprues dhe ka në bazë ekipin, siç citohet në kurikul.

**Bariu:** Është përgjegjës për nxitjen dhe trajnimin e nxënësve gjatë gjithë takimit, duke përfshirë lidhjen e tyre me një mik dhe ndihmon ata që vijnë për herë të parë, të ndihen të mirëpritur.

### **Këshilla për drejtuesin**

Të gjithë drejtuesit duhet të qëndrojnë gjatë gjithë mësimit në klasë duke u angazhuar me nxënësit dhe duke i ndihmuar ata sipas nevojës.

Për grupe më të vogla, Drejtuesi i kohës së zbulimit dhe Bariu mund të jenë i njëjti person.

## **Pasqyra bazë e programit**

Programi përbëhet nga pesë elemente:

1. Loja e përsëritjes
2. Adhurimi
3. Koha e zbulimit
4. Mësimi nga Bibla
5. Loja e fundit e përsëritjes

Këto pjesë janë të lidhura fort me njëra-tjetrën, të cilat krijojnë një ambient mësimi me kohë të plotë, ku çdo minutë është e rëndësishme dhe çdo nxënës përfshihet për të mësuar pikat kryesore të mësimit apo një objektivi të Hartës së gjurmuesit.

### **Program i sugjeruar**

-: 20 Vullnetarë të gatshëm dhe të përgatitur për të mirëpritur nxënësit teksa mbërrijnë  
-: 15 Loja e përsëritjes  
: 00 Adhurimi  
: 15 Koha e zbulimit  
: 30 Mësimi nga Bibla  
: 60 Loja e fundit e përsëritjes  
: 65 Marrja e nxënësve nga prindërit

## **Loja e përsëritjes**

### **Këshilla për drejtuesin**

Drejtuesit të cilët nuk janë duke i mirëpritur nxënësit ndërsa hyjnë në klasë, duhet t'i ndihmojnë dhe t'i nxisin ata gjatë Lojës së përsëritjes. P.sh, Duke brohoritur!

Sigurohu që vizitorët të ndihen të mirëpritur dhe përpiqu t'i bashkohesh me një mik të ri nga klasa jote.

Loja e përsëritjes është krijuar që të jetë argëtuese dhe energjike, për të rishikuar mësimet dhe temat e mëparshme nga Harta e gjurmuesit. Koha shfrytëzohet më së miri teksa fëmijët vijnë dhe për prindërit është gjëja e parë që shohin!

Udhëzimet për lojën e përsëritjes gjenden te shtojca.

## Adhurimi

### Këshilla për drejtuesin

Inkurajo nxënësit të jenë të respektueshëm dhe të marrin pjesë duke bërë lëvizjet e caktuara të këngëve, dhe/ose duke qëndruar thjesht në këmbë në shenjë respekti. Drejtuesit duhet të parandalojnë dhe të korrigjojnë çdo lloj sjellje shqetësuese.

Adhurimi është hartuar për të:

- paraqitur mësimin e ditës
- mësuar se çfarë është adhurimi
- modeluar adhurimin autentik
- nxitur pjesëmarrjen në adhurim

Në një javë të zakonshme, adhurimi përmban dy ose tre këngë. Kurikula e adhurimit gjendet te shtojca.

## Koha e zbulimit

Aktivitetet e Kohës së zbulimit (KZ) janë krijuar për t'i angazhuar dhe sfiduar nxënësit përmes mësimit praktik. Përmes KZ-së, ata do të përjetojnë një emocion ose një reagim që do t'i ndihmojë të lidhen personalisht me mësimin e Biblës. Ndonjëherë aktiviteti i KZ-së do të përdoret për të krijuar një "pamje të paharrueshme" të mësimit biblik, siç mund të jetë një ndjenjë, një aromë apo një shije e diçkaje te rrëfimi i Biblës.

### Këshilla për drejtuesin

Sigurohu që të kuptosh paraprakisht se si KZ-ja lidhet me mësimin dhe se si do të funksionojë aktiviteti. Nëse nuk je i sigurt, kontakto drejtuesin e shërbesës. Dhe mbaj mend, drejto me entuziazëm; KZ-të janë pjesë emocionuese e takimit të fëmijëve!

## Mësimi nga Bibla

Mësimi i Biblës është një përvojë e udhëhequr nga mësuesi, i cili e bën Biblën të gjallë për nxënësit. Ungjilli është i ndërthurur në çdo mësim. Atje ka një skicë të Shkrimit për të ndihmuar në udhëheqjen e mësimi:

**Kreu i seksionit:** Ky informacion është vetëm për mësuesin (jo për dialog).

**Lexo:** Shkrime nga Bibla për t'ia lexuar nxënësve me zë të lartë.

**Përmbledhje:** Pasi të keni lexuar pjesën nga Shkrimi, merr kohë për t'iu shpjeguar se çfarë do të thotë ajo pjesë. "Përmbledhja" shpesh bën një pyetje, përcakton fjalët kyç, ose rishpreh tablonë e asaj që lexuat, në nivelin e një fëmije.

**Parafrazim:** Kjo do të thotë se nuk keni nevojë ta lexoni pjesën drejtpërdrejt nga Bibla (për shkak të kohës, gjatësisë së vargjeve, ose për shkak se mbulon një temë të vështirë që duhet të bëhet më e përshtatshme për fëmijët). Ju lutemi, mos e lexoni tekstin e parafrazuar drejtpërdrejt nga kurikula.

### **Hapat e sugjeruar për përgatitjen e mësimit nga Bibla:**

1. Lutu për drejtimin dhe udhëheqjen e Perëndisë! Gjithashtu kalo kohë duke u lutur për nxënësit e tu emër për emër.
2. Lexo Shkrimin nga Bibla jote – nënvizo pikat kryesore! Kjo kurikul është hartuar mbi themelin e Fjalës së Perëndisë dhe mësimit rreth të vërtetës së Tij nga Fryma e Shenjtë. Është e rëndësishme që të gjithë drejtuesit të lexojnë fragmente nga Shkrimi, përpara se të lexojnë skicën e mësimit nga Bibla. Kurikula mund të përmbajë gabime, por Bibla është e pagabueshme.
3. Lexo pyetjet shqyrtuese të mësimit!
4. Lexo kurikulën!
5. Planifiko mësimin! Sigurohu që të përdorësh kalimin e aktivitetit të KZ-së për të prezantuar dhe/ose theksuar pikën “Vepro si duhet” të mësimit.
6. Bëje mësimin më të gjallë duke përdorur mjete, figura apo veprime, si dhe duke përdorur ide krijuese nga kurikula.
7. Praktiko mësimin në mënyrë që “t’i jepni jetë Biblës”, duke pasur emocion në zë dhe kontakt të mirë me sy.
8. Mësuesit duhet t’i kenë Biblat e hapura gjatë gjithë mësimit, në mënyrë që nxënësit të dinë se ngjarja vjen nga Bibla. Të gjithë nxënësit duhet t’i hapin Biblat te pasazhi nga Shkrimi siç i drejton mësuesi (shih seksionin “Gjejeni” në prezantimin e mësimit). (Nxënësit më të vegjël mund të kenë nevojë për ndihmë.) Për shkak të kohës së limituar dhe vlerës që i japim përdorimit të Biblave nga nxënësit, ju lutemi mos e lexoni mësimin nga një libër me histori biblike.

## **Loja e fundit e përsëritjes**

Lojërat e thjeshta të përsëritjes i gjeni te shtojca e kurikulës. Drejtuesit e kohës së zbulimit ose Barinjtë drejtojnë lojën e përsëritjes ndërsa prindërit janë duke marrë fëmijët. Mësuesi kryesor shpërndan etiketat shpërblyese dhe lidhet me prindërit.

### **Këshilla për drejtuesin**

Shpërbleji pyetjet përsëritëse! Mund t’i kthesh në pyetje E vërtetë/E gabuar ose në pyetje me alternativa, si të përshtaten më mirë për moshën dhe nivelin e klasës.

## Materialet për klasën

Për mësimin iu jepen materialet e mëposhtme:

- Kronologjia e Biblës
- Libri pa fjalë
- 12 vargjet kyç
- Fletushka *T'i udhëzosh fëmijët drejt shpëtimit*
- Broshura *E beson apo jo?*
- Libër shënuesi *Unë besoj*
- Broshura *Çfarë ndodh më pas?*
- Postera me librat e Dhiatës së Vjetër dhe të Re
- Etiketat shpërblyese
- Posterit *Ndihuni si duhet*
- Harta e kohëve të Biblës

## Etiketat shpërblyese

Etiketat shpërblyese mund të fitohen nga nxënësit gjatë mësimin dhe të shpenzohen më pas në Tregun e zbulimit.

### Kursi i këmbimit:

- 3 Marrja e Biblave me vete (për fëmijët më të vegjël)/ Përdorimi i Biblave (për më të rriturit)
- 2 Pjesëmarrja aktive në klasë
- 1 Shfaqja e frytit të Frymës
- 1-5 Aktivitetet e Kohës së zbulimit (specifikuar në kurikul)
- 5 Plotësimi i Thesareve të gjurmuesit dhe kthimi i kuponit
- 10 Vizitori dhe miku që sjell vizitorin

## Thesaret e gjurmuesit

Thesaret e gjurmuesit janë letra shumëngjyrëshe, të përshtatshme për fëmijët dhe familjet që t'i marrin në shtëpi. Është një mënyrë shumë e mirë për të krijuar bashkëpunim me prindërit. Thesaret e gjurmuesit i edukon për atë që po mësojnë fëmijët dhe i sfidon ta aplikojnë mësimin në shtëpi gjatë javës. Pasi të plotësohet aktiviteti sfidues si familje, nxënësit mund të kthejnë kuponin te mësuesi dhe të marrin pesë Etiketa shpërblyese.



# PËRMBLEDHJA E TREMUJORIT

## Viti 1 – Tremujori 2

Këtë tremujor do të vazhdojmë udhëtimin përmes Biblës ndërsa studiojmë librin e Lukës. Siç mësuam tek Zanafilla, Perëndia kishte premtuar një Shpëtimtar për botën. Ashtu si besimtarët sot shikojnë pas dhe besojnë në atë Shpëtimtar që erdhi dhe vdiq për mëkatin tonë, patriarkët e Dhiatës së Vjetër mezi prisnin dhe besonin në premtimin e Perëndisë për Shpëtimtarin që do të vinte një ditë. Studimi i librit të Lukës na zbulon se si premtimi u bë realitet. Lutja jonë është që, përmes këtij studimi, shumë nxënës do të besojnë në Zotin dhe Shpëtimtarin tonë, Jezusin, dhe se ata që besojnë do të rriten në hirin dhe njohjen e Tij.

Perëndia kishte vepruar gjatë 400 viteve pas kohëve të regjistruara të Dhiatës së Vjetër. Edhe pse Ai nuk foli drejtpërdrejt me njerëzit, siç kishte bërë në Dhiatën e Vjetër, Fjala e Tij e shkruar vazhdonte të fliste. Shumë judenj u mbajtën në premtimin e Fjalës së Tij dhe jetuan në shpresën e Shpëtimtarit që do të vinte. Një ditë, kur një priift i quajtur Zakaria po shërbente me besnikëri në tempullin e Zotit në Jerusalem, Perëndia theu heshtjen. Engjëlli i Tij i foli Zakarias dhe lajmëroi se ai dhe gruaja e tij Elizabeta, përmes një mrekullie, do të kishin një djalë, i cili do të përgatiste popullin e Izraelit për ardhjen e Zotit. Engjëlli i Perëndisë i foli gjithashtu një vajze të re të quajtur Mari dhe i dha lajmin më të jashtëzakonshëm – ajo do të ishte nëna e vetë Birit të Perëndisë, Shpëtimtarit të botës. Fjala e Perëndisë u përmbush për Zakarian, Elizabetën dhe Marinë. U përmbush edhe për ne. Prandaj mund të themi gjithmonë me gëzim: “Unë do të besoj në Fjalën e Perëndisë.”

Pikërisht siç kishte premtuar Perëndia, Zakaria dhe Elizabeta patën një djalë të quajtur Gjon, dhe Maria pati një djalë të quajtur Jezus. Kur Jezusi lindi, Perëndia foli sërish përmes engjëllit të Tij me disa barinj që po ruanin delet në fusha. Ishte lajmi më i mirë i historisë njerëzore: Shpëtimtari i botës kishte lindur në Bethlehëm! Kur dëgjuan atë që shpallën engjëjt, barinjtë nxituan të shihnin Shpëtimtarin foshnjë, dhe kur e panë, ua treguan të tjerëve Lajmin e Mirë. Sepse, si mund të mos e tregonin? Ne kemi të njëjtin Lajm të Mirë, ndaj duhet t’u tregojmë të tjerëve se Jezusi lindi për të qenë Shpëtimtari ynë.

Pasi lindi Jezusi, Maria dhe burri i saj, Jozefi, bënë atë që thoshte Ligji i Perëndisë. E rrethprenë Jezusin në ditën e tetë dhe më vonë e prezantuan të sapolindurin, Birin e Perëndisë, në tempullin e Jerusalem. Në tempull ata patën dy takime të mrekullueshme. I pari ishte një njeri i quajtur Simeon, i cili kishte pritur me durim të shihte Shpëtimtarin para se të vdiste. Takimi i dytë ishte një profeteshë e vjetër e quajtur Ana, e cila e njohu foshnjën Jezus si Shpëtimtarin. Siç mund ta shohim,

Perëndisa shpërbleu durimin e tyre dhe nga ata mësojmë të presim me durim Perëndinë.

Edhe pse Perëndia nuk na ka zbuluar shumë nga fëmijëria e Jezusit, Ai na informon për një ngjarje shumë të rëndësishme. Jozefi dhe Maria ishin besnikë në pjesëmarrjen e përvitshme të festës së Pashkës në Jerusalemin. Kur Jezusi ishte 12 vjeç qëndroi në tempull pas festës, duke mësuar nga mësuesit e tempullit dhe duke u rritur në urtësi. Megjithatë prindërit e tij u tronditën nga zhdukja e menduar e tij, Ai u siguroi me qetësi se shtëpia e Atit të Tij ishte pikërisht vendi ku duhet të ishte. Fjala e Perëndisë na thotë se Jezusi vazhdoi të rritej në urtësi dhe na thotë të bëjmë edhe ne të njëjtën gjë. Prandaj duhet t'i përkushtohemi studimit të përditshëm të Fjalës së Perëndisë, që të mund të rritemi në urtësi.

Jezusi u rrit dhe erdhi koha e Tij për të filluar shërbesën. Në bindje ndaj Atit të Tij Qielor, Jezusi shkoi të pagëzohej nga Gjon Pagëzori. Pak kohë pas pagëzimit të Tij dhe tundimit nga Satani në shkretëtirë, Jezusi shkoi të jepte mësim në sinagogë në qytetin e Tij, Nazaret. Përmes mësimit atë ditë, Ai u tha njerëzve në sinagogë se Ai ishte Shpëtimtari që kishin pritur. Por në vend që ta pranonin, ata e refuzuan. Në vend që të zgjidhnin Jezusin si Shpëtimtarin e tyre, judenjtë në Nazaret e refuzuan dhe u përpoqën ta vrasin. Por, prej atij refuzimi dhe vdekjes së Tij në kryq, secili prej nesh ka mundësinë ta zgjedhë Jezusin si Shpëtimtar.

Jezusi shpëtoi nga hebrenjtë në Nazaret dhe vazhdoi shërbesën e Tij. Përveç mësimit dhe predikimit, Jezusi bëri shumë mrekulli. Mrekullitë e Tij të shërimit kanë qenë prova që u duhej njerëzve për të besuar se Ai ishte Biri i Perëndisë, Shpëtimtari i botës. Edhe pse shumë njerëz në kohën e Jezusit erdhën tek Ai për shërim fizik, qëllimi i Tij në botë ishte të vdiste në kryq dhe të ringjallej, që ata të mund të shëroheshin frymërisht nga mëkati i tyre. Ata që janë shëruar frymërisht nga Jezusi e dinë që, ose tani ose në të ardhmen, Ai do të na shërojë edhe fizikisht. Ne ecim në këtë jetë duke besuar se Jezusi mund të na shërojë.

Gjatë kohës së Jezusit në tokë, drejtuesit fetarë u përpoqën shumë herë ta zhvlerësonin dhe të kundërshtonin faktin se Ai ishte Shpëtimtari. Këta burra të vetëdrejtësuar i anashkalonin shumë lehtësisht mrekullitë e Tij dhe urtësinë e Tij, dhe me keqdashje sulmonin dashurinë dhe mëshirën e Tij. Kjo sjellje u bë shumë e dukshme një mbrëmje, kur Simoni fariseu e ftoi Jezusin për darkë. Një grua mëkatore erdhi dhe adhuroi Jezusin, duke larë këmbët e Tij me lotët dhe flokët e saj, duke i puthur e duke i vajosur me parfum. Simoni e përqeshi në vend që të përulej e të kuptonte se ishte po aq mëkatar sa ajo. Ky kontrast i errët na ndihmon të pranojmë me përujë se jemi mëkatarë.

Ndërsa Jezusi vazhdonte shërbesën e Tij, njerëzit që dëshmonin mrekullitë e Tij të mëdha dhe dëgjonin mësimet e Tij me autoritet, pyesnin veten se kush ishte Ai dhe diskutonin mes tyre mundësitë. Jezusi i dinte hamendësimet e tyre, dhe një ditë, ndërsa kalonte kohë me dishepujt e Tij, Ai i përballi me një pyetje: “Kush thoni ju se jam Unë?” Kur Pjetri iu përgjigj se Ai ishte Mesia i Perëndisë, Jezusi i paralajmëroi dishepujt të mos kishin turp prej Tij, duke u shpjeguar se, nëse duam këtë jetë më shumë se Atë, do ta humbasim. Ky paralajmërim na ndihmon të jemi të guximshëm dhe të mos kemi turp për Jezusin.

Përgjatë shërbesës së Jezusit, “ekspertët” në Ligjin e Perëndisë e testuan me pyetje për ta vënë në vështirësi. Një ekspert i tillë i bëri Jezusit pyetjen e drejtë, por me qëllimin e gabuar. Kur e pyeti Jezusin se çfarë duhet të bënte për të fituar jetën e përjetshme, Jezusi e pyeti se çfarë thoshte ligji, që është, të duash Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht. Në vend që, me përulje të pranonte se ishte i paaftë ta bënte këtë, eksperti u përpoq të gjente hapësira boshe në ligj. Jezusi iu përgjigj me shëmbëlltynë e samaritanit të mirë. Eksperti dukej jo i gatshëm të kuptonte se po fliste me të vetmin që e donte vërtet Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht, dhe se gjithë të tjerët dështojnë në këtë. Vetëm kur besojmë tek Ai që e deshi Perëndinë dhe të tjerët përsosmërisht mund t'i duam vërtet të tjerët.

Ndërsa i afrohem fundit të një tremujori tjetër, ne marrim një ditë për të kujtuar e përsëritur gjithçka që Perëndia na ka mësuar përmes studimit të Fjalës së Tij. Pas dy javësh do të rikthehemi te libri i Lukës, për të vazhduar studimin e jetës, vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit, gjithashtu do të nisim studimin e jetës së apostullit Pal në librin e Veprave.

# MËSIMI 1

## Luka 1

<b>Kupto si duhet:</b>	Engjëlli lajmëron ardhjen e Jezusit dhe të Gjon Pagëzorit.
<b>Mendo si duhet:</b>	“Ki besim tek ZOTI me gjithë zemër dhe mos u mbështet në mençurinë tënde; pranoje në të gjitha rrugët e tua dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua.” Fjalët e Urta 3:5-6 (12 vargjet kyç)
<b>Vepra si duhet:</b>	Unë do të besoj në Fjalën e Perëndisë.
<b>Ndihuni si duhet:</b>	Unë mund të ndihem i gëzuar kur besoj në Fjalën e Perëndisë.

## PËRGATITU!

Fjalët e Urta 3:5-6 është një nga pasazhet e preferuara të 12 vargjeve kyç për shumë persona. Ama, një gjë është ta dish, e tjetër gjë ta vësh në veprim. Mund të jetë e vështirë ta vendosim besimin te dikush tjetër por, kur e njohim vërtet Atë që është 100% i besueshëm, marrëdhënia jonë me Të bëhet “jeleku ynë i shpëtimit” midis dallgëve të jetës. Këtë javë, ndërsa përgatitemi për të shërbyer, le të shqyrtojmë veten dhe t’i kërkojmë Perëndisë të na rrisë besimin në Të.

**Lutu:** Lutu që Perëndia të të japë të kuptuarit e qartë të Shkrimit dhe që nxënësit në klasën tënde të kuptojnë nevojën e miqve të tyre për një Shpëtimtar.

Lexo: Luka 1

### **Kupto si duhet: Engjëlli lajmëron ardhjen e Jezusit dhe të Gjon Pagëzorit**

Perëndia kishte vepruar gjatë 400 viteve pas kohëve të regjistruara të Dhiatës së Vjetër. Edhe pse Ai nuk foli drejtpërdrejt me njerëzit, siç kishte bërë në Dhiatën e Vjetër, Fjala e Tij e shkruar vazhdonte të fliste. Shumë judenj u mbajtën në premtimin e Fjalës së Tij dhe jetuan në shpresën e Shpëtimtarit që do të vinte. Një ditë, kur një prift i quajtur Zakaria po shërbente me besnikëri në tempullin e Zotit në Jerusalem, Perëndia theu heshtjen. Engjëlli i Tij i foli Zakarias dhe lajmëroi se ai dhe gruaja e tij Elizabeta, përmes një mrekullie, do të kishin një djalë, i cili do të përgatiste popullin e Izraelit për ardhjen e Zotit. Engjëlli i Perëndisë i foli gjithashtu një vajze të re të quajtur Mari dhe i dha lajmin më të jashtëzakonshëm – ajo do të ishte nëna e vetë Birit të Perëndisë, Shpëtimtarit të botës. Fjala e Perëndisë u përmbush për Zakarian, Elizabetën dhe Marinë. U përmbush edhe për ne. Prandaj mund të themi gjithmonë me gëzim: “Unë do të besoj në Fjalën e Perëndisë.”

# BËHU GATI!

## Ide krijuese për mësimin biblik:

- Cakto këto personazhe për mësimin: Elizabeta, Zakaria, Maria, foshnja Gjon dhe foshnja Jezus. Mund të jenë kukulla, vizatime ose forma të prera me karton. Mos shëno emra mbi to, por ndërsa shpjegon, shto objekte ose fjalë që lidhen me personat.
- Përdor kostume dhe inskenoje mësimin.

# NISU!

## Loja e përsëritjes para shërbesës dhe adhurimi

Drejtimesit e adhurimit do t'i drejtojnë nxënësit në një lojë përsëritjeje ndjekur nga adhurimi. Hollësirat gjenden te shtojca.

## Koha e zbulimit: A mund të të besoj?

**Qëllimi:** T'i sfidojmë nxënësit t'i besojnë një mesazhi duke u mbështetur tek ai dhe duke qenë vërtet të bindur për të.

## Aktiviteti 1: Stacioni i kutive

### Mjetet:

- Kuti ose çanta – sillni sa më shumë të tilla, që hapen e mbyllen lehtësisht (synim: të paktën pesë kuti për çdo nxënësi)
- Pesë etiketa të arta (burim i printueshëm)
- Një kuti e veçantë dhuratash, në ngjyrë të artë, me të paktën pesë dhurata brenda (ide për dhurata: 20 etiketa shpërblyese ose çmime të tjera si çokollata apo karamelle me mbështjellëse ngjyrë floriri)
- Një zarf i artë me një mesazh të veçantë brenda: “Pesë nga kutitë/çantat kanë një etiketë të artë. Synimi yt është të gjesh atë që ka etiketën e artë! Kushdo që gjen një etiketë të artë, do të marrë një dhuratë të veçantë nga kjo kuti e artë në fund të Kohës së zbulimit! Nëse e gjen një etiketë të artë, duhet të ulesh menjëherë mënjane.” (burim i printueshëm)



**Udhëzime për ambientin:** Përpara fillimit të Kohës së zbulimit, vendosi pesë etiketat e arta brenda pesë kutive/çantave dhe sigurohu që të gjitha kutitë/çantat të jenë të vendosura në një grumbull të madh në hapësirën e KZ-së. Kutia e artë (me pesë dhurata brenda) dhe zarfi i artë duhet të vendosen në një zonë të veçantë, larg kutive/çantave dhe duhet t'i nxisin dhe t'i emocionojnë nxënësit.

## Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:


1. Kur nxënësit të arrijnë në stacionin e kutive, habitu me ta për zarfin e artë dhe për kutinë e artë të dhuratave. Thekso që kjo duket si një mesazh vërtet **i besueshëm**. Lexoje mesazhin e veçantë që gjendet brenda zarfit, duke shfaqur emocion. Nxiti nxënësit për gjetjen e etiketave të arta!
2. Thuaju nxënësve se mund të hapin sa kuti të duan derisa të gjejnë etiketën e artë; por, kur hapin një kuti që nuk ka etiketën e artë, duhet ta mbyllin dhe ta vendosin prapë te grumbulli i kutive. E njëjta kuti do të hapet disa herë. Kjo do ta shtojë entuziazmin te nxënësit. Demonstroje hapjen dhe mbylljen e kutive. Informoju nxënësit që, nëse nuk e mbyllin kutinë që kanë hapur, do të pezullohen nga loja për dhjetë sekonda, gjë që ul mundësinë e tyre për të gjetur një etiketë të artë.
3. Thuaj: “A i **besoni** këtij mesazhi të veçantë? A mendoni se vërtet gjenden pesë etiketa të arta dhe se, kushdo që gjen një etiketë të artë do të marrë një dhuratë të veçantë? A jeni të emocionuar? Atëherë, le të fillojmë! Përgatituni! Gati, nisu!”
4. Ti, bashkë me mësuesin kryesor dhe bariun, duhet të shihni nxënësit që nuk i mbyllin kutitë dhe t’u kërkoni të qëndrojnë larg për dhjetë sekonda, gjithashtu ndihmoni duke u siguruar që kutitë të jenë të mbyllura mirë pasi hapen.
5. Përsërite herë pas here fjalën **besim** duke thënë: “Unë e di që mund t’i **besojmë** mesazhit që gjendet në zarf, duhet të ketë patjetër pesë etiketa të arta.”
6. Kur një nxënës gjen një etiketë të artë, kërkoji të ulet mënjane (çdo nxënës mund të gjejë vetëm një etiketë).
7. Sigurohu që të gjenden të pesta etiketat e arta (kjo është shumë e rëndësishme për suksesin e KZ-së).
8. Në fund të Kohës së zbulimit hap kutinë e artë të dhuratave dhe jepi secilit nga nxënësit ose 20 etiketa shpërblyese, ose një dhuratë të veçantë.
9. Përforcoje duke përsëritur faktin se je i gëzuar që ata i **besuan** mesazhit.

**Këshillë për Kohën e zbulimit:** për klasa me më shumë nxënës, ndaji në grupe për kryerjen e aktivitetit.

## Aktiviteti 2: Stacioni i ushqimit

### Mjetet:

- Përbërës për pudingun – puding me çokolatë, krem pastiçerie, grimca shumëngjy-rëshe për spërkatje
- “Haribo” si krimba (pesë gjysma për t’i fshehur në puding dhe pesë qese të vogla me “Haribo” për fituesit)
- Tasa të cekët
- Peceta
- Gushore plastike
- Një kuti e veçantë, e artë me pesë dhurata brenda (qeset e vogla me “Haribo”-t)



- Një zarf i artë me këtë mesazh të veçantë brenda: “Pesë nga tasat me puding kanë nga një gjysmë “Haribo”-je në formë krimbi brenda. Duhet ta konsumoni pudingun pa përdorur duart. Po, do të bëheni pis! Kushdo që gjen krimbin fiton një dhuratë të veçantë!” (burim i printueshëm)

**Udhëzime për ambientin:** vendos një gjysmë “Haribo”-je në fund të secilit prej tasave të cekët (gjysma e “Haribo”-s krimb do ta bëjë më të vështirë gjetjen), pastaj bëj aq tasa me puding dhe grimca shumëngjyrëshe për spërkatje sa nxënës ke, dhe vendosi në frigorifer. Shtojë kremin e pastičerisë para se të vijë nxënësit. Për të nxitur përfshirjen, vendos kutinë e artë (me pesë dhuratat brenda) dhe zarfin e artë diku ku nxënësit mund t’i shohin.

### Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:


1. Kur nxënësit të arrijnë në stacionin e ushqimit, trego entuziazëm për zarfin e artë. Thekso se duket si një mesazh, të cilit vërtet mund t’i **besosh**. Lexoje me entuziazëm mesazhin e veçantë brenda zarfit. Nxiti vërtet nxënësit për gjetjen e “Haribo”-ve në puding!
2. Pyet: “A i **besoni** mesazhit të veçantë? A mendoni se është e vërtetë që pesë nga tasat me puding kanë “Haribo” në formë krimbi brenda, dhe a besoni që, nëse gjeni një prej tyre, do të merrni një dhuratë të veçantë? E po, mirë pra, kryqëzohini duart pas kurrizit – nuk mund t’i përdorni duart derisa të keni gjetur “Haribo”-t – dhe bëhuni gati. Nëse gjeni një “Haribo”, ma tregoni dhe ngrijeni lart që ta shoh. A jeni të emocionuar? Kur të them: “Nisul!”, mund të filloni.
3. Shpërndaj nxënësve tasat me puding, që ishin në frigorifer.
4. Pyet: “A i **besoni** këtij mesazhi të veçantë? Sa “Haribo” në formë krimbash janë fshehur? (Pesë!) A mendoni se është e vërtetë se kushdo që gjen një “Haribo”, do të marrë një dhuratë të veçantë? A jeni të emocionuar? Atëherë le të fillojmë! Përgatituni! Gati, nisul!
5. Vazhdo të përsërisësh fjalën **besim**, ndërsa nxënësit hanë pudingun.
6. Në fund të Kohës së zbulimit, hap kutinë e dhuratave dhe jepu nxënësve që kanë gjetur “Haribo”-t, një qese të vogël me “Haribo”.

**Këshillë për Kohën e zbulimit:** Çelësi për ta bërë të suksesshme KZ-në është t’i lësh me frymën pezull në fillim. Nëse i lejon nxënësit ta hanë pudingun që në fillim, do të humbasësh aspektin edukativ të kësaj përvoje.

### Aktiviteti 3: Stacioni i artit

#### Mjetet:

- Kartona bosh për poster (nga një për çdo skuadër)
- Konë për skuadrat (nga një për secilën)
- Kova/kuti me lapustila



- Shembull posterit me ngjyra për Fjalët e Urta 3:5-6 (në disa raste mund të përdorësh simbole si një zemër apo një shteg, të vizatuara në vend të fjalëve)
- Një zarf me ngjyra të ndezura brenda të cilit gjendet ky mesazh: “Skuadra që bën posterin më krijues për të ilustruar vargjet nga Fjalët e Urta 3:5-6, do të marrë një dhuratë të veçantë në fund të Kohës së zbulimit.” (burim i printueshëm)
- Një kuti e veçantë dhuratash, shumëngjyrëshe, e mbushur me çmime për skuadrën fituese (çmimi duhet të jetë shpërblim i mirë për mundin e tyre, për shembull një pako me karamelle apo çokollata)
- Zile



**Udhëzime për ambientin:** vendos një karton bosh pranë çdo skuadre. Kova/kutia me lapustila duhet vendosur 6 metra larg nga skuadrat. Kutia e dhuratave dhe zarfi duhet të vendosen në një vend të dukshëm, që të ketë emocion dhe pritshmëri.

### Udhëzime për drejtuesin e KZ-së:

1. Ndaji nxënësit në skuadra (më së shumti pesë nxënës për skuadër).
2. Kërkoju nxënësve të recitojnë Fjalët e Urta 3:5-6. Nxënësit mund t'i referohen posterit shembull nëse kanë nevojë.
3. Trego habi për faktin që gjendet një zarf dhe një kuti shumëngjyrëshe në një vend të dukshëm. Nxirr mesazhin nga zarfi dhe lexojua nxënësve.
4. Thuaj: “A i **besoni** këtij mesazhi? A mendoni se është e vërtetë që do të zgjedhim posterin e skuadrës më krijuese dhe se skuadra fituese do të marrë një dhuratë të veçantë? Atëherë bëni më të mirën tuaj. Për ta bërë edhe më argëtuese do ta zhvillojmë si një ‘stafetë’ arti. Kur të them: “Nisuni!”, personi i parë nga çdo skuadër do të vrapojë dhe do të marrë një lapustilë, do të kthehet mbrapsht me vrap dhe do të fillojë të vizatojë në poster. Kur të dëgjoni zilen, kalojani lapustilën njërit prej shokëve të skuadrës, i cili më pas do të vrapojë për te koshi/kutia e lapustilave, do të zgjedhë një ngjyrë të re dhe do të vrapojë mbrapsht për të vizatuar. Sa herë të dëgjoni zilen, duhet të ndërroni lapustilën dhe artistin. (Zilja do të bjerë mesatarisht çdo tridhjetë sekonda.) Anëtarët e skuadrës mund të udhëzojnë artistin në lidhje me atë që duhet të shkruajë apo të vizatojë, por nuk mund të prekin lapustilën apo letren.” (Me zgjedhje: me raste mund t’u kërkosh skuadrave të vrapojnë nga dy veta për te koshi i lapustilave.)
5. Pyet: “A jeni të sigurt se i **besoni** këtij mesazhi? A jeni të emocionuar? Atëherë, le të fillojmë. Përgatituni! Gati, nisu!



6. Në fund të aktivitetit, përforcoje mesazhin dhe fjalën **besim**, pastaj zgjidh skuadrën fituese dhe jepu një shpërblim nga kutia e dhuratave.
7. Kërkoju nxënësve t'i varin posterat në një hapësirë ku mund t'i shohin prindërit dhe familjarët.
8. Thekso faktin që ne mund të **besonim** se kishte një çmim në kuti dhe se mesazhi ishte i saktë.

## Prezantimi i mësimit nga Bibla

**Mësuesit kryesorë – lidhja e KZ-së me mësimin:** Kur mbërritët në Kohën e zbulimit, morët një mesazh të veçantë për një çmim që mund ta fitonit. A i **besuat** mesazhit? Ishte shumë e qartë se çfarë duhet të bënit për të marrë dhuratën e veçantë. E pashë që shumë prej jush ishit të entuziazmuar për dhuratën. A u pëlqeu dhurata atyre që e morën? Ai mesazh i veçantë ishte i vërtetë, për shkak se ndodhi vërtet.

Në mësimin e sotëm biblik do të mësojmë për disa njerëz që ishin vërtet të gëzuar për një dhuratë të mrekullueshme, që do të merrnin. Fjala e Perëndisë u tregoi specifikisht se çfarë do të ndodhte. Disa që e dëgjuan Fjalën e Perëndisë, **besuan** se ishte e vërtetë. Ata pritën dhe u entuziazmuar. Dhe e dini çfarë ndodhi? Dhurata më në fund erdhi! Mund të **besojmë** gjithmonë se Fjala e Perëndisë është e vërtetë!

**Lutu:** *Inkurajo njërin nga nxënësit ta drejtojë klasën në lutje. Kjo do t'i ndihmojë të mësojnë të lutën kur ka njerëz dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre drejtuese frymërore.*

**Zbulojë:** *Shkruaj referencën e vargut, Luka 1:1, në tabelë dhe kërkoju nxënësve t'i hapin Biblat te Luka 1:1. Mësoju se referenca është “adresa” e vargut në Bibël. Kujtoju nxënësve se Luka është libri, numri i parë është kapitulli dhe numri i dytë është vargu. Ata që janë për herë të parë, dhe moshat më të vogla mund të kenë nevojë për ndihmë. Nëse nxënësit kanë përparuar, mund të përdoret metoda “Stërvitja me shpata”.*

*Çfarë është “Stërvitja me shpata?” Si mësues, ti thua: “Biblat lart!” Nxënësit duhet t'i shtrijnë krahët lart me Bibla drejtuar nga tavani. Pastaj ti thua librin, kapitullin dhe vargun. Nxënësit duhet ta përsërisin pas teje. Pasi të gjithë nxënësit të kenë përsëritur librin, kapitullin dhe vargun, ti thua: “Nisuni!”. Nxënësi i parë që vendos gishtin te vargu, do të marrë një etiketë shpërblyese.*

**Kronologjia:** *Drejtoje gishtin për nga periudha historike te figura që përkon në rreshtin e kronologjisë së Biblës. Thekso se Luka është në Dhiatën e Re.*

**Prezantim me tremujorin dhe mësimin nga Bibla:** *Përpara se të hidhemi në mësimin e ditës, le të mendojmë pak se ku gjendeshim javën e kaluar në Dhiatën e Vjetër dhe ku gjendemi këtë javë në Dhiatën e Re. Si lidhen Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re me*

njëra-tjetrën? Njerëzit në Dhiatën e Vjetër po prisnin me entuziazëm dhe me **besim** që Shpëtimtari i premtuar po vinte. Edhe Adami dhe Eva, njerëzit e parë, e dinin se një Shpëtimtar po vinte për t'i shpëtuar nga mëkati i tyre. Ata **besonin** se ajo që Perëndia tha, ishte e vërtetë. Sot do të lexojmë për një premtim që u dha në Dhiatën e Vjetër dhe u përmbush në Dhiatën e Re.

## Përvijimi i Shkrimit: Luka 1

### Prezantim me Lukën

#### **Parafrazim i Luka 1:1-4:**

Gjejeni se kush e shkroi librin e Lukës... (Luka). Luka ishte një doktor që besonte se Jezusi ishte Shpëtimtari, dhe ai donte që edhe njerëzit e tjerë të besonin në Jezusin. Prandaj e shkroi librin e Lukës. Le të dëgjojmë se çfarë shkroi Luka për Jezusin.

### Zakaria zbulon se do të ketë një djalë

#### **Parafrazim i Luka 1:5-17:**

Ishte një prift i quajtur Zakaria, i cili kishte një grua të quajtur Elizabeta. Të dy e donin dhe e ndiqnin Perëndinë. Nuk kishin fëmijë dhe, megjithëse ishin të vjetër, vazhdonin të luteshin për një fëmijë. Kur ishte radha e Zakarias të shërbente në tempull, diçka e mrekullueshme ndodhi! Engjëlli i Perëndisë, Gabrieli, erdhi te Zakaria me një mesazh të veçantë. Mesazhi ishte që ai dhe Elizabeta do të kishin një fëmijë shumë të veçantë, dhe do ta quanin Gjon. Gabrieli tha se Gjoni do t'i përgatiste njerëzit për të shumëpërturim Shpëtimtar. A e dini se kujt po i referohej engjëlli? (Jezusit!) Jezusi po vinte!

Sa të entuziazmuar mendon se ishin njerëzit kur morën vesh se Jezusi po vinte? Mendoni pak se sa të entuziazmuar ishit për dhuratën që mund të fitonit gjatë Kohës së zbulimit. Ata ishin shumë më tepër të entuziazmuar se aq. A e dëgjove se çfarë shkroi Luka? Shpëtimtari i premtuar nuk u shfaq nga hiçi. Perëndia kishte një plan. Ai do të dërgonte Gjonin për të përgatitur rrugën për Jezusin. Dhe çudia më e madhe ishte se Gjoni do të lindte nga dy njerëz shumë të vjetër! Kur ne i besojmë Perëndisë, Ai bën gjëra të mrekullueshme!

A e gjeni dot se çfarë i tha Zakaria engjëllit?

### Zakaria vë në dyshim fjalët e engjëllit

#### **Lexo Luka 1:18-20**

**Përmbledhje:** Oh jo! Zakaria nuk i besoi Gabrielit dhe tani nuk do të mund të fliste derisa foshnja të lindte! Çfarë na thotë të bëjmë pjesa 'Mendo si duhet'? Le ta themi tani. Recitoni Fjalët e Urta 3:5-6.

Zakaria nuk mund ta kuptonte se si ai dhe Elizabeta mund të kishin një fëmijë, sepse ishin shumë të vjetër. Ai po mbështetej në të kuptuarit e tij, kur në fakt duhet të besonte në Fjalën e Perëndisë. Perëndia e bën gjithmonë atë që thotë se do të bëjë. A ju kujtohet ndonjë çift tjetër, të cilit Perëndia i tha se do të bëheshin me fëmijë, kur ishin të vjetër? (Abrahami dhe Sara) A ishte Fjala e Perëndisë e vërtetë atëherë? (Po) A do t'i besosh Fjalës së Perëndisë?

**Për nxënësit më të rritur:** Kjo pjesë e Biblës na ndihmon të kuptojmë rëndësinë e të besuarit tek Ai. A ka raste kur je mbështetur në të kuptuarit tënd, në vend që t'i besojë Fjalës së Perëndisë? A mund të japësh një shembull? Lër kohë për diskutime të shkurtra dhe bëj sugjerime, kur është e nevojshme, p.sh., probleme familjare, sfida në shkollë, një mik që të ka lënduar, sëmundje, humbja e punës së një prindi, shpërngulje, humbja e një kafshe shtëpiake apo humbja e një personi të afërt etj. Pavarësisht çfarë ndodh, ne duhet të drejtohem te Perëndia për ndihmë dhe pastaj duhet t'i besojmë Atij dhe Fjalës së Tij. Kur po përballesh me një problem, mendo rreth Fjalëve të Urta 3:5-6 dhe kujto se mund ta vendosësh shpresën dhe besimin te Perëndia!

### **Elizabeta mbetet shtatzënë**

#### ***Parafrazim i Luka 1:21-25:***

Kur Zakaria doli nga tempulli, njerëzit e kuptuan se diçka e rëndësishme kishte ndodhur, për shkak se nuk mund të fliste dhe po u drejtohej atyre me shenja. Zakaria u kthye në shtëpi dhe Elizabeta mbeti shtatzënë. Ishte një mrekulli! Ajo do të kishte një fëmijë, pikërisht siç kishte thënë engjëlli! Fëmija i tyre do të ishte ai që do të përgatiste rrugën për Jezusin!

### **Maria zbulon se do të lindte një djalë**

#### ***Parafrazim i Luka 1:26-27:***

Pas kësaj, engjëlli Gabriel shkoi te një vajzë e re e quajtur Mari dhe i tha se do të kishte një fëmijë që do të ishte Biri i Perëndisë! Kjo do të ishte një mrekulli, për shkak se fëmija nuk do të kishte një njeri si babain e Tij të vërtetë. Gabrieli i tha Marisë ta quante Birin e saj "Jezus". Gabrieli i tha gjithashtu Marisë se edhe e afërmja e saj Elizabeta do të kishte një fëmijë. Dëgjoni se çfarë tha Maria:

#### **Lexo Luka 1:38**

**Përmbledhje:** A besoi Maria në Fjalën e Perëndisë që ia tha Gabrieli? (Po)

### **Maria viziton Elizabetën**

#### ***Parafrazim i Luka 1:39-56:***

Maria shkoi të takonte Elizabetën dhe, sapo e përshëndeti, foshnja e Elizabetës u hodh nga gëzimi. Edhe Elizabeta, edhe foshnja që ende s'kishte lindur, Gjoni, e dinin se Jezusi po vinte! A nuk është entuziazmuere kjo?

A e imagjinon dot të jesh një nga njerëzit që pritën e pritën për të parë e për të takuar Jezusin, Shpëtimtarin e vetëm të vërtetë, të kësaj bote? Kur Perëndia thotë se do ta bëjë diçka, Ai do ta bëjë! Ashtu siç ju i besuat mesazhit në Kohën e zbulimit, ashtu mund të besoni se ajo që Perëndia thotë është e vërtetë.

## Gjoni lind

### **Parafrazim i Luka 1:57-79:**

Rreth tre muaj më vonë lindi foshnja e Elizabetës. Kur ajo dhe Zakaria e quajtën Gjon, Zakaria mundi të flasë sërish. Zakaria ishte shumë i lumtur! Ai kishte një djalë dhe e dinte se Shpëtimtari, Jezusi, po vinte për t'i shpëtuar njerëzit nga mëkati i tyre. A i besonte tani Zakaria mesazhit të Perëndisë? (Po!)

## Gjoni rritet

### **Lexo Luka 1:80**

**Përmbledhje:** Gjoni u rrit dhe jetoi në shkretëtirë derisa Perëndia vendosi që ai të kryente punën e Tij të veçantë. Puna ishte të përgatiste njerëzit, sepse Jezusi po vinte! Gjoni u bë i njohur si Gjon Pagëzori, sepse ai pagëzonte njerëzit që pendoheshin, për mëkatet e tyre. Çfarë do të thotë fjala “pendim”? (Të largohesh nga mëkati dhe të pranosh që ke nevojë për Jezusin.) Më pas Gjon Pagëzori pagëzoi edhe Jezusin!

## **Përfundimi**

Perëndia kishte një plan të veçantë dhe dërgoi Fjalën e Tij te Zakaria dhe te Maria përmes engjëllit Gabriel. Gjithçka që Perëndia tha, u përmbush. Zakaria dhe Elizabeta u bënë me një fëmijë edhe pse ishin shumë të vjetër. Javën e ardhshme do të zbulojmë se çfarë ndodhi me Marinë. Kujtoni se çfarë tha engjëlli: “Jezusi po vjen!”

## **“Vepra si duhet” dhe “Ndihi si duhet”**

Perëndia kishte një punë të veçantë për Gjonin. Puna e Gjonit ishte të përgatiste njerëzit, sepse Jezusi po vinte t'i shpëtonte nga mëkati. Perëndia ka një punë të veçantë edhe për ty. Së pari, Ai dëshiron që ti të besosh në Jezusin që të të shpëtojë nga mëkati dhe ta bësh Atë udhëheqësin e jetës tënde. *Shpall Ungjillin përmes “Librit pa fjalë”*. Pasi ta kesh bërë këtë, Ai dëshiron që ti të ndihmosh të tjerët të besojnë në Jezusin gjatë kohëve të mira dhe të këqija në jetën e tyre. A e di përse?

Fjala e Perëndisë na thotë se Jezusi do të kthehet sërish. Një ditë, Ai do të kthehet dhe njerëzit që besojnë në Jezusin do të kenë jetë të përjetshme me Të. Por njerëzit që

nuk besojnë tek Ai, do të ndahen nga Perëndia përgjithmonë. A beson se Fjala e Perëndisë është e vërtetë? A beson se Jezusi do të kthehet një ditë, siç na thotë në Fjalën e Tij? Mund të jetë çfarëdo dite, prandaj, le të bëjmë punën që Perëndia dëshiron që ne të bëjmë, dhe t'u tregojmë njerëzve për Jezusin! A je i gëzuar? Nëse nuk ke besuar në Jezusin për shpëtim nga mëkati, a do të doje të besoje sot? Ne do të sigurohemi që të kuptosh se si të besosh tek Ai dhe do të të japim mundësinë ta bësh tani. *Mundësi për të prezantuar qartësisht Ungjillin dhe gjithashtu për t'u dhënë mundësinë të luten për shpëtim.*

## **Loja e fundit e përsëritjes: Çfarë zbuluam sot?**

*Drejtuesi i KZ-së apo Bariu do t'i drejtojë nxënësit në një lojë përsëritjeje. Idetë për lojë gjenden te shtojca.*

1. Çfarë i tha engjëlli i Perëndisë, Gabrieli, Zakarias në tempull? (Ai dhe Elizabeta do të kishin një fëmijë dhe do ta quanin Gjon.)
2. A i besoi Zakaria mesazhit të Perëndisë nga Gabrieli? (Jo.)
3. Çfarë i ndodhi Zakarias për shkak se nuk i besoi mesazhit të Perëndisë? (Ai nuk do të mund të fliste derisa të lindte foshnja dhe ta quanin Gjon.)
4. Cila do të ishte puna e Gjonit, kur të rritej? (Të përgatiste njerëzit për Jezusin.)
5. Çfarë i tha Gabrieli Marisë? (Ajo do të lindte Birin e Perëndisë dhe do ta quante Jezus.)
6. A i besoi Maria mesazhit të Perëndisë nga Gabrieli? (Po.)
7. Çfarë bëri foshnja në barkun e Elizabetës, kur Maria e përshëndeti? (U hodh nga gëzimi në barkun e Elizabetës.)
8. Përse u hodh nga gëzimi Gjoni në barkun e Elizabetës? (Sepse Jezusi po vinte!)
9. A u përmbushën premtimet e Perëndisë ndaj Zakarias, Elizabetës dhe Marisë? (Po.)
10. A mund të besosh ti se Fjala e Perëndisë është e vërtetë?